

# **TENDENCAT OLIGARKIKE NË SHQIPËRI DHE NEVOJA PËR NJË PROCES DE-OLIGARKIZIMI**

**NJË PËRPIEKJE PËR TË VLERËSUAR DHE  
MATUR PËRQËNDRIMIN E PUSHTETIT  
EKONOMIK DHE POLITIK**

**JANAR 2023**

## **Dokument Politikash**

# **TENDENCAT OLIGARKIKE NË SHQIPËRI DHE NEVOJA PËR NJË PROCES DE-OLIGARKIZIMI**

**Një përpjekje për të vlerësuar dhe matur  
përqëndrimin e pushtetit ekonomik dhe politik**

© Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)

Tiranë, Janar 2023



Ky është dokumenti i tretë i politikave i përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit:

***“Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)”***

mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë

**Autorë:**

Mirsada HALLUNAJ

**Redaktimi dhe korigjimi:**

Arjan DYRMISHI

**Dizajni dhe faqosja:**

Ergys TEMALI



Kingdom of the Netherlands

# Përmbajtja

<b>Lista e Shkurtimeve/Grafikë &amp; Tabela</b> .....	5
<b>Përmbledhje</b> .....	6
<b>Hyrje</b> .....	8
<b>Kuadri Teorik: Të përkufizosh dhe matësh Oligarkinë</b> .....	9
<b>Kapja e Shtetit (STATE CAPTURE)</b> .....	10
<b>Qëllimi i Dokumentit</b> .....	11
<b>Metodologjia &amp; Të Dhënat</b> .....	11
<b>Target Grupi/Kufizime</b> .....	12
<b>Pjesa I: Tregues dhe të Dhëna</b> .....	13
<b>Pabarazia në të Ardhura dhe Pasuri</b> .....	14
<b>Mungesa e Konkurrencës</b> .....	17
<b>Reduktimi dhe Shmangia e Taksave</b> .....	18
<b>Pjesa II: Ndikimi dhe Lidhjet Politike</b> .....	19
<b>Lidhjet e politikës me biznesin dhe përfshirja e biznesmenëve në politikë</b> .....	20
<b>Financimi i Partive Politike</b> .....	20
<b>Pronësia dhe Kontrolli mbi Median</b> .....	21
<b>Pjesa III: Mbrojtja, Zgjerimi dhe Përqëndrimi i Pasurisë</b> .....	22
<b>Partneritetet Publik Privat (PPP)</b> .....	23
<b>Prokurimet Publike</b> .....	25
<b>Investimet Strategjike</b> .....	26
<b>SHTOJCA A</b> .....	27
<b>Përfundime dhe Rekomandime</b> .....	28
<b>Bibliografia</b> .....	29

## Lista e Shkurtimeve

<b>AIDA</b>	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
<b>ASD</b>	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
<b>BB</b>	Banka Botërore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BERZH</b>	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>BIRN</b>	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
<b>BSH</b>	Banka e Shqipërisë
<b>DASH</b>	Departamenti Amerikan i Shtetit
<b>FSHZH</b>	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
<b>IS</b>	Investimet Strategjike
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>KIS</b>	Komiteti i Investimeve Strategjike
<b>PE</b>	Parlamenti Evropian
<b>PPP</b>	Partnitetet Publik Privat
<b>PP</b>	Prokurimet Publike
<b>SPAK</b>	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

## Grafikë & Tabela

<b>Grafik 1</b>	Pabarazia në të Ardhura (2000 - 2021)
<b>Grafik 2</b>	Pabarazia në Pasuri (2000 - 2021)
<b>Grafik 3</b>	Indeksi i koeficientit Gini, 1996–2017
<b>Grafik 4</b>	Pesha e Depozituesve më të Mëdhenj ndaj Totalit të Depozitave Bankare (%)
<b>Grafik 5</b>	Pesha e Depozituesve Individëve dhe Shoqërive Tregtare ndaj Totalit të Depozitave Bankare
<b>Grafik 6</b>	Indeksi i Përqëndrimit të Tregut HH, 2000–2020
<b>Grafik 7</b>	Të ardhura nga Dividenti në Milion Lekë
<b>Grafik 8</b>	Numri Total i Projekteve me Koncesione/PPP të miratuara ndër vite, 2004-2022
<b>Figura 1</b>	Kriteret e përdorura në ligjet për de-oligarkizimin, me qëllim identifikimin e personave me pushtet ekonomik dhe politik (oligarkë)
<b>Tabela 1</b>	Komponentët dhe Treguesit e Metodologjisë
<b>Shtojca A</b>	Përmbledhje e numrit të projekteve Koncesionare, Investimeve Strategjike, Platformave Mediatike dhe Vlerave të Kontratave të Prokurimit të zotëruara dhe fituara nga 40 personat më të pasur në vend

## Përmbledhje

Prania e korrupsionit dhe përshkallëzimi i këtij fenomeni në Shqipëri përgjatë më shumë se dy dekadëve të fundit, përveçse përkeqësimit të një sërë aspektesh të jetës ekonomike dhe shoqërore të vendit, **nxorri në pah gjithnjë dhe më shumë një formë të sofistikuar të qeverisjes, nëpërmjet së cilës interesa private filluan të ushtronin një ndikim të konsiderueshëm në proceset vendimmarrëse shtetërore me qëllim përfitimin e favoreve dhe avantazheve të ndryshme ekonomike dhe politike.**

Si një vend në tranzicion, në të cilin zbatimi i reformave ekonomike dhe politike u shoqërua me kriza të njëpasnjëshme, **Shqipëria ofroi mundësinë për krijimin e një ekosistemi të favorshëm për ndërtimin e lidhjeve klienteliste dhe abuzive me qëllim depërtimin e tyre në sistemet qeveritare, politike, të drejtësisë apo ato administrative.** Miratimi i reformës në sistemin e drejtësisë në vitin 2016, por edhe rezultatet që lidhen me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shkarkuar nga procesi i rivlerësimit, evidentuan seriozitetin e situatës dhe nivelin e depërtimit të korrupsionit në vend.

Për shkak të këtyre zhvillimeve edhe biznesi si një hallkë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të vendit, do ta kishte të vështirë të qëndronte i përjashtuar nga nevoja për ti shërbyer interesave të caktuara të politikës, e cila siç rezultoi gjatë viteve në vijim kontribuoi gjithashtu në konsolidimin e pozitave dhe pushtetit të biznesit mbi politikën. Kjo solli që gjithnjë e më shumë **ligjërimi politik në Shqipëri, të dominohej nga termat “oligarkë” dhe “oligarki”, duke ju referuar disa individëve të pasuruar në mënyra dhe forma të dyshimta, të lidhur pashmangshmërisht me persona me pushtet politik.**

\*\*\*

Qëllimi i këtij dokumenti politikash për të trajtuar dhe vlerësuar prezencën e tipareve të një qeverisjeje oligarkike në një këndvështrim teorik dhe empirik të munguar deri tani në Shqipëri, erdhi pikërisht si pasojë e nevojës **për ti dhënë përgjigje një sërë pyetjesh që lidhen në tërësi me përqëndrimin në rritje të pushtetit ekonomik dhe politik në funksion të interesave personale të një grupi të ngushtë individësh.**

Në mungesë të metodologjive të mëparshme referuese për të matur dhe vlerësuar këtë fenomen, por edhe vështirësive që lidhen me konfuzitetin dhe gjerësinë e përkufizimit të termit, **dokumenti synon gjithashtu të nxisë ndërmarrjen e analizave dhe studimeve më të hollësishme në drejtim të matjes të ndikimit që ka në jetën dhe politikën publike pushteti politik dhe ekonomik i përqëndruar tek një grup i ngushtë individësh (oligarkë).**

Gjithsesi, kufizimet e parashtruara më lart nuk e kanë bërë të pamundur kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës në drejtim të konsolidimit në rritje të marrëdhënieve favorizuese klienteliste, të cilat janë shoqëruar me problematika të tilla si **monopolizimi i tregjeve, mungesa e konkurrencës, mirëqënia e ulët ekonomike, infomaliteti dhe papunësia, rritja e pabarazive në të ardhura dhe pasuri dhe cënimi i kohezionit social.** Përveç vlerësimit të situatës që lidhet me këto çështje, analiza përfshin edhe **kriteret kryesore të përcaktuara së fundmi në ligjet për de-oligarkizimin të tilla si: i) ndikimi dhe lidhjet politike, ii) përqëndrimi i pasurisë iii) tendencat për zgjerimin e kësaj pasurie.**

\*\*\*

Gjatë viteve të fundit në Shqipëri gjithnjë e më shumë është evidentuar **një rritje e përfshirjes së biznesmenëve në politikë,** kjo edhe për shkak të **nevojës që kanë partitë politike për të siguruar mbështetje financiare gjatë fushatave zgjedhore** duke shpënë që burimet financiare ti ofrojnë mundësinë komunitetit të biznesit të bëhet një faktor i rëndësishëm në zgjedhje. Si pasojë, **akuzat për lidhje kriminale me përfaqësues politikë apo qarkullim të parave të pista në periudha fushatash zgjedhore** kanë dominuar skenën politike në vend, duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis të favorshëm edhe për **përfshirjen e biznesmenëve apo edhe të personave me një të shkuar të errët në listat e kandidatëve për deputetë.**

Presioni dhe kontrolli mbi mediat dhe gazetarët përbën gjithashtu një nga mënyrat e përdorura nga individët me pushtet financiar për të manipuluar aktivitetet si edhe lidhjet e tyre me politikën. Përveçse anësive në informim dhe mungesës së profesionalizimit, kjo situatë ka krijuar ndër vite një **përqëndrim gjithnjë e më në rritje të tregut të medias në duart e një grupi të vogël individësh të pasur për shkak të lidhjeve politike dhe për rrjedhojë një kontrolli të theksuar mbi të gjitha organet e shtypit.** Mediat private shqiptare më me ndikim

rezulton të zotërohen nga një pjesë e vogël e kompanive që kanë lidhje me politikanët, ndërsa operojnë në të njëjtën kohë në sektorë të tjerë fitimprurës.

\*\*\*

Forcimi i lidhjeve dhe pushtetit politik ka patur tendencën për të shpënë me kalimin e kohës jo vetëm në mbrotjen e përfitimeve të krijuara, por edhe në zgjerimin e tyre. **Shqipëria shënon një numër rekord kontratash koncesionare, ndërkohë që zbatimi i tyre është shoqëruar nga një sërë sfidash dhe problematikash, ndër të cilat mospërbushja e qëllimeve afatgjata dhe standardeve ndërkombëtare, mungesa e konkurrencës dhe transparencës, moskryerja e shërbimeve, etj.** Rritja e numrit të kontratave koncesionare është vlerësuar gjithashtu se ka reduktuar mundësitë për konkurrencë, përfshirë investimet e huaja në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë. **Deri në fund të vitit 2022 kanë rezultuar aktive 11 kontrata koncesionare të financuara nga buxheti i shtetit, 7 prej të cilave arrijnë vlerën e kontratës në mbi 5,000,000,000 Lekë.** Thujse zbatimi i të gjitha këtyre kontratave ka rezultuar problematik duke nxjerrë në pah afëra korruptive dhe klienteliste.

Edhe sektori i prokurimeve publike megjithëse përbën një nga fushat më të rëndësishme ndërsektoriale, vazhdon të mbetet **një fushë mjaft e ndjeshme sa i përket korrupsionit dhe favorizimeve, pasi shumica e rasteve kanë të bëjnë me oferta të manipuluar, dhënie të rryshfetit dhe favorizime politike ose familjare.** Situatat e emergjencës siç ishin **pandemia e Covid-19 dhe ai i fatkeqsisë natyrore të tërmetit,** theksuan edhe më shumë abuzimet në sektorin e prokurimeve.

Nga ana tjetër zbatimi i ligjit për investimet strategjike është konsideruar se përbën problematika serioze që lidhen me: **tërheqjen e parave të pista dhe sjelljeve klienteliste në favor të oligarkëve, cënimin e pronës private duke nxitur konflikte sociale, favorizimin e pak personave të lidhur me pushtetin, pa sjellë ndonjë ndikim të dukshëm në ekonomi, mungesën e transparencës dhe mbi të gjitha krijimin e të gjitha mundësive për për krijimin e oligarkisë.**

**Një pjesë e konsiderueshme e zotëruesve të kontratave koncesionare apo projekteve që lidhen me investimet strategjike janë ndër individët më të pasur në vend, ndërkohë që prezenca e tyre evidentohet edhe në zotërimin e një pjese të mediave kryesore si edhe në fitimin e kontratave me vlera të larta në fushën e prokurimit publik, duke bërë që gjithnjë e më shumë përqëndrimi i pasurisë tek pak individë të rritet.**

\*\*\*

Pavarësisht se problematikat e renditura më lart përbëjnë një pengesë serioze të Shqipërisë për të arritur nivelin e duhur të përgatitjes për t'ju përgjigjur ritmeve dhe dinamikës së procesit të integritimit, **hapja e negociatave me Bashkimin Evropian në korrik të vitit 2022 ofron mundësinë për adresimin e një sërë sfidash të shumta që lidhen me përgatitjen e vendit në kuadër të këtij procesi.**

Krijimi i një ekonomie funksionale tregu, e cila të jetë e aftë të konkurrojë me forcat e tregut brenda Unionit përbën një nga nga kriteret kryesore të këtij procesi. Sipas raporteve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, **niveli i përgatitjes së vendit në drejtim të kapacitetit për të përballuar trysinë konkurrese mbetet i ulët** ku përgjatë 4 viteve të fundit (2019-2022) Shqipëria është vlerësuar me një farë niveli përgatitjeje.

Evidentimi dhe forcimi i lidhjeve korruptive dhe klienteliste me qëllim favorizimin e ndërsjelltë të një grupi të ngushtë individësh nga biznesi dhe politika mund të konsiderohet një nga kërcënimet kryesore të qeverisjes në Shqipëri, ku **përqëndrimi i pushtetit ekonomik vazhdon të krijojë problematika në krijimin e një klime jo të shëndetshme të kohezionit social dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi.**

Në këtë kontekst dhe me qëllim adresimin e shqetësimeve në kohën e duhur për të mos krijuar pasoja serioze të destabilitetit social dhe ekonomik, nevojitet një **ndërgjegjësim serioz në mesin e klasës politike që mund të konsiderohet edhe përgjegjëse kryesore për krijimin dhe konsolidimin e kësaj forme qeverisjeje.** Nga ana tjetër, përveç nevojës për të reduktuar ndikimin e interesave private mbi politikën dhe ekonominë si edhe siguruar transparencë të plotë dhe masa të forta që nxisin një ekonomi konkurruese **nevojitet të zhvillohen instrumenta dhe metodologji specifike për të matur dhe vlerësuar periodikisht lidhjet dhe përqëndrimin e pushtetit ekonomik dhe politik në Shqipëri si dhe ndikimin e tyre në avancimin e përbushjes së një sërë kriteresh kyçe për anëtarësim në BE.**

## Hyrje

Kur flitet për integrimin evropian të Shqipërisë shpesh procesi lidhet vetëm ose kryesisht me përmbushjen e kriterëve politike apo teknike, duke i kushtuar një vëmendje më të pakët përmbushjes së kriterëve ekonomike, të cilat lidhen me një ekonomi tregu funksionale dhe me kapacitet për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut. Në fakt bashkëpunimi ekonomik dhe integrimi në tregun e përbashkët evropian përbën një nga parakushtet kryesore dhe më të rëndësishme të këtij procesi dhe për rrjedhojë ai nuk mund të shihet i shkëputur nga procesi politik dhe përmbushja e kriterëve të tjera themelore.

Por pavarësisht kësaj, në Shqipëri është konstatuar se përveç mungesës së informacionit dhe nivelit jo të duhur të përgatitjes për t'ju përgjigjur ritmeve dhe dinamikës së procesit të integrimin në BE, ka një kontroll dhe lidhje të dukshme të biznesit vendas, kryesisht sektorëve më fitimprurës me elitën politike drejtuese të vendit, lidhje të cilat shpesh janë ndërtuar bazuar mbi korrupsionin dhe interesa të tjera të anasjellta me qëllime përfitimi.

Prania dhe dominanca e këtyre fenomeneve përgjatë dekadave të fundit ka bërë gjithnjë dhe më prezente diskutimet mbi krijimin e shtresës së oligarkëve dhe ndikimin e tyre në vendimmarrje të rëndësishme që lidhen me përvetësimin e pasurive publike apo favoreve të tjera në funksion dhe shërbim të pasurimit të tyre si edhe mbrojtjes apo edhe zgjerimit të kësaj pasurie.

Pasojat e krijuara nga monopolizimi i tregjeve, mungesa e konkurrencës, mirëqënia e ulët ekonomike si dhe një sërë pasojash të tjera të ngjashme kanë çenuar besimin e qytetarëve tek institucionet shtetërore, të cilët e shohin si një problem tashmë shqetësues mbizotërimin e lidhjeve klienteliste me politikën dhe pasojat që kjo ka krijuara në ekonomi dhe më gjerë.<sup>1</sup>

Prezenca e oligarkëve dhe vetë ndërtimi i një sistemi qeverisës oligarkik, shpesh është perceptuar si një fenomen i cili i përket vetëm vendeve në të cilat korrupsioni mbetet një problem serioz, duke u konsideruar në këtë mënyrë një fenomen thuajse përjashtues për vende të tjera të zhvilluara dhe model i sistemeve demokratike.

Për një periudhë të gjatë, duke nisur pas viteve 90' pas shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik (BS), vende si Rusia dhe ish-republika të BS janë konsideruar modeli më tipik i krijimit dhe fuqizimit të oligarkëve. Madje, në vende si Ukraina, Gjeorgjia dhe Moldavia nuk kanë munguar edhe masa radikale që lidhen me de-oligarkizimin.<sup>2</sup>

Gjithsesi vende të tjera me sisteme demokratike nuk e përjashtojnë prezencën e oligarkëve dhe përpjekjeve të tyre në drejtim të mbrojtjes dhe zgjerimit të pasurisë nëpërmjet lidhjeve dhe abuzimeve politike.<sup>3</sup> Integrimi në BE i ish-vendeve komuniste si Hungaria, Çekia, Bullgaria, Sllovakia apo Polonia dhe problematikat që një pjesë e mirë e tyre shfaqën në lidhje me abuzimet me fondet agrikulturore të cilat ranë në duart e disa sipërmarrësve të mëdhenj në fushën e agrikulturës, për të mbështetur më pas partitë në pushtet me influencën e tyre dhe me donacione, do të krijonte brenda Unionit një shqetësim serioz dhe marrjen e masave konkrete.<sup>4</sup>

Në këtë kontekst, diskutimet e shumta mbi oligarkët dhe oligarkinë kanë risjellë në vëmendje nevojën për një trajtim dhe adresim gjithëpërfshirës të këtij fenomeni. Sfidat dhe problematikat me të cilat është përballuar Shqipëria gjatë dekadave të fundit e bëjnë po kaq të nevojshëm dhe aktual diskutimin mbi këtë fenomen, për të cilin nevojitet një trajtim sa teorik aq edhe empirik.

<sup>1</sup> Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), [Barometri i Sigurisë Shqipëri 2022](#)

<sup>2</sup> Komisioni Evropian, [The European Commission recommends to Council confirming Ukraine, Moldova and Georgia's perspective to become members of the EU and provides its opinion on granting them candidate status](#), Qershor 2022

<sup>3</sup> Project Syndicate, [Why Stop at the Russian Oligarchs?](#), Mars 2022

<sup>4</sup> Parlamenti Evropian, [REPORT on MFF 2021-2027: fight against oligarch structures, protection of EU funds from fraud and conflict of interest](#), Mars 2022



## Kuadri Teorik: Të përkufizosh dhe matësh Oligarkinë

Termet “oligarkë” dhe “oligarki” përbëjnë ndoshta termat më të përdorur në ligjërimin politik dhe më gjerë në Shqipëri gjatë dekadës së fundit. Vlerësuar si një vend ku korrupsioni ka qenë dhe vazhdon të konsiderohet një nga problematikat dhe sfidat kryesore,<sup>5</sup> të ashtëquajturit “oligarkë” janë konsideruar si pjesë e pandashme e realitetit shqiptar, duke nënkuptuar në një mënyrë ose tjetër disa individë të pasuruar në mënyra dhe forma të dyshimta, të lidhur pashmangshmërisht me persona me pushtet, kryesisht politikanë por jo vetëm.

Megjithë përkufizimet e hershme që ekzistojnë për oligarkinë,<sup>6</sup> është evidentuar se ka një mungesë të theksuar në drejtim të trajtimeve teorike dhe empirike që lidhen me të, duke qenë një nga konceptet më pak të qarta,<sup>7</sup> më inkohente dhe më pak të teorizuara në shkencat sociale.<sup>8</sup> Në këtë kontekst, qëllimi për të ofruar një përkufizim të qartë të termit si dhe ndërtuar një kuadër konceptual, i cili ti shërbejë pyetjeve kërkimore që shtrohen ka qenë një nga sfidat, por edhe objektivat kryesore të këtij dokumenti politikash.

Fillimisht, për shkak të origjinës së termit, pjesa më e madhe e interpretimeve apo përkufizimeve që lidhen me oligarkinë janë fokusuar kryesisht dhe vetëm tek komponenti që lidhet me “qeverisjen e të paktëve” apo “qeverisjen nga pak njerëz”.<sup>9</sup> Aristoteli do të ishte i pari, i cili do ta përkufizonte termin si ushtrimin e pushtetit nga qytetarët më të pasur, të cilët gjithmonë ndodh që të jenë “të pakët” në numër,<sup>10</sup> përkufizim ky i cili do të merrej, përshtatej dhe zgjerohej më tej nga një sërë autorësh dhe studiuesish.

Ndër vite, përkufizimi mbi oligarkinë është përdorur për të përshkruar një sistem politiko-ekonomik.<sup>11</sup> Deri në shekullin e 20' oligarkia është përcaktuar si një lloj regjimi apo sistemi politik i korruptuar ku pak individë drejtojnë në dëm të pjesës tjetër bazuar në përfitimet dhe interesat e tyre vetjake personale.<sup>12</sup> Ndërkohë që studiues të tjerë janë përpjekur ta përkufizojnë oligarkinë edhe nga një pikëpamje normative.<sup>13</sup>

Përgjatë viteve të fundit studiues të tjerë kanë ofruar qasje të ndryshme nga nocionin tradicional i oligarkisë si një formë regjimi apo qeverisjeje, duke e përcaktuar oligarkinë si një fenomen të pranishëm edhe në shoqëritë demokratike, ku një grup i ngushtë njerëzish të pasur ushtrojnë ndikimin dhe lidhjet e tyre politike në funksion të grumbullimit dhe mbrojtjes së pasurisë dhe pushtetit edhe pa qenë pjesë e strukturave qeverisëse të shtetit.<sup>14</sup>

Nga ana tjetër ajo çfarë evidentohet nga analiza lidhet me faktin se mungesa e një kuadri teorik të qartë mbi oligarkinë ka sjellë për pasojë edhe mungesën e vlerësimeve të plota dhe gjithëpërfshirëse, të cilat ti shërbejnë nevojës për të matur dhe verifikuar praninë e oligarkisë (apo tipareve që e përbëjnë atë). Për rrjedhojë kanë munguar edhe mekanizmat për mbledhjen e të dhënave si dhe instrumenta për monitorimin dhe vlerësimin e prezencës së oligarkisë.

<sup>5</sup> Transparency International, [Corruption Perceptions Index](#)

<sup>6</sup> Aristotle, Politics, Book 3

<sup>7</sup> Leach, D. K., 2005, “The Iron Law of What Again? Conceptualizing Oligarchy Across Organizational Forms”

<sup>8</sup> Winters, J. A. (2011) Oligarchy

<sup>9</sup> Enciklopedia Ndërkombëtare e Shkencave Sociale tregon se fjala e ka prejardhjen nga fjala greke oligarkhia (qeverisja e të paktëve), e cila përbëhet nga oligoi (pak) dhe arkhein (të drejtosh). Në këtë mënyrë oligarkia është një formë qeverisjeje në të cilën pushteti politik është në duart e një pakice të vogël.

<sup>10</sup> Aristotle 1996, III viii 1279b, 35–39

<sup>11</sup> - Michels, R. (1915) Political Parties – A Sociological Study of the Oligarchical Tendencies of Modern Democracies

- Schmidt, A.J. (1973) Oligarchy in Fraternal Organizations: A Study in Organizational Leadership

- Samons, L. J., 1998, “Mass, Elite, and Hoplite-Farmer in Greek History”

- Leach, D. K., 2005, “The Iron Law of What Again? Conceptualizing Oligarchy Across Organizational Forms”

<sup>12</sup> - Mansfield, H. C. Jr., 1983, “On the Impersonality of the Modern State: A Comment on Machiavelli's Use of Stato”

- McCormick, J. P., 1993, “Addressing the Political Exception: Machiavelli's 'Accidents' and the Mixed Regime”

<sup>13</sup> - Fogel, K., 2006, “Oligarchic Family Control, Social Economic Outcomes, and the Quality of Government”

- Gilens, M., and Page, Benjamin I., 2014, “Testing Theories of American Politics: Elites, Interest Groups, and Average Citizens”

<sup>14</sup> - Winters, J. A. (2011) Oligarchy

- Krugman, P. (4 Nëntor, 2011), [“Oligarchy, American Style”](#), The New York Times


- Johnson, S., 2009, [“The Quiet Coup.”](#) The Atlantic 52

Ligjet për de-oligarkizimin të miratuara gjatë viteve të fundit në vende si Ukraina dhe Gjeorgjia ofrojnë disa kriteret specifike për evidentimin e oligarkëve si dhe marrjen e masave konkrete penalizuese në drejtim të tyre. De-oligarkizimi u kërkua si një nevojë emergjente ndaj ish-republikave të ish-Bashkimit Sovjetik. Do të ishte vetë Bashkimi Evropian i cili do ti kërkonte këtyre vendeve si një kusht kyç për anëtarësimin në Bashkimin Evropian zbatimin e angazhimit për de-oligarkizim, me qëllim eliminimin e ndikimit të interesave të caktuara në jetën ekonomike, politike dhe jetën publike.<sup>15</sup>

Në nëntor të vitit 2021 Ukraina miratoi e para ligjin për de-oligarkizimin, duke e konsideruar luftën ndaj oligarkëve si një parandalim të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare, ndërkohë që bazuar në po të njëjtin model në nëntor të vitit 2022 edhe Gjeorgjia miratoi ligjin e saj për de-oligarkizimin.

Ligjet mbi de-oligarkizimin ofrojnë një kuadër ligjor, i cili synon të shkëpusë bizneset e mëdha nga ndikimi politik duke kufizuar ndikimin e dëmshëm të interesave personale të pak individëve të privilegjuar (oligarkë) në jetën ekonomike të vendit, duke përcaktuar kriteret të qarta për identifikimin e tyre.

**1) Pjesëmarrja në jetën politike, 2) zotërimi dhe ndikimi mbi organe të medias, 3) zotërimi dhe përfitimi nga biznese monopol si edhe 4) vlera të larta të aseteve dhe kapitalit, përbëjnë kriteret që parashikojnë ligjet për de-oligarkizimin në identifikimin e personave (oligarkë), të cilët përdorin pushtet të konsiderueshëm ekonomik dhe politik në jetën publike.**



*Figura 1: Kriteret e përdorura në ligjet për de-oligarkizimin, me qëllim identifikimin e personave me pushtet ekonomik dhe politik (oligarkë)*

## Kapja e Shtetit (STATE CAPTURE)

Duke qenë se korrupsioni ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga fenomenet më serioze dhe prezente në shoqërinë shqiptare, ai është trajtuar gjerësisht nga shumë studiues dhe hulumtues të fushave të ndryshme. Zhvillimet ndër vite që kanë ndodhur në Shqipëri kanë sjellë një fokus në shumë prej formave të korrupsionit, por veçanërisht vitet e fundit janë fokusuar tek fenomene të tilla si kapja e shtetit (state capture), koncepti i cili është konsideruar si forma më e lartë e korrupsionit.<sup>16</sup>

Si pasojë e depërtimit dhe pasojave që korrupsioni ka krijuar në shoqërinë shqiptare, mund të konsiderohet pa mëdyshje si gjeneza kryesore që ka shpënë në cënimin e besimit, dobësimin e demokracisë, pengimin e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e pabarazive dhe varfërisë. Përdorimi sistematik i praktikave korruptive në shoqëri dhe çfarë është më shqetësuesja pranimi i tyre, kanë bërë që ndër vite ky fenomen të konsolidohet në mënyrën se si është manifestuar duke depërtuar thellë në shoqëri dhe duke sjellë përdorimin e tij në forma edhe më të sofistikuar dhe me kosto të mëdha.

Nga abuzimi me pushtetin e dhënë për qëllime përfitimi personale,<sup>17</sup> i cili mund të kryhet nga kushdo, korrupsioni ka gjeneruar në Shqipëri fenomene edhe më shqetësuese siç është kapja e shtetit, për të cilin është folur shumë gjatë viteve të fundit. Kapja e shtetit i referohet një lloji korrupsioni më sistematik, duke manipuluar formulimin dhe/ose zbatimin e politikave në avantazh të një grupi të caktuar (zakonisht me lidhje politike) për qëllime personale përfitimi.<sup>18</sup>

<sup>15</sup> Komisioni Evropian, [The European Commission recommends to Council confirming Ukraine, Moldova and Georgia's perspective to become members of the EU and provides its opinion on granting them candidate status](#), Qershor 2022

<sup>16</sup> Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), ["Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri 2008-2020"](#), Mars 2021

<sup>17</sup> Transparency International, [WHAT IS CORRUPTION?](#)

<sup>18</sup> World Bank Group, [State Capture Analysis : A How to Guide for Practitioners](#) (2021)

Krijimi i oligarkëve dhe oligarkisë pashmangshmërisht nuk mund të ndodhë pa këtë proces, pasi në thelb të qëllimeve të këtyre individëve qëndrojnë interesa ekonomike dhe pasurore, mbrojtja apo zgjerimi i të cilave siç u theksua më lart realizohet nëpërmjet lidhjeve dhe ndikimit politik. Në këtë kontekst, kapja e shtetit nuk është absolutisht një fenomen i veçantë nga ai i krijimit të oligarkisë, por përbën në vetvete procesin nëpërmjet të cilit oligarkët arrijnë qëllimet e tyre duke shpënë vendin në një qeverisje oligarkike.

Duke patur parasysh këtë, ky dokument politikash ka si qëllim kryesor të përshkruajë, analizojë dhe vlerësojë të dhënat dhe faktet kryesore që dëshmojnë ose jo mbi prezencën e lidhjeve dhe përfitimeve oligarkike, duke mos trajtuar dhe duke mos u ndaluar specifikisht dhe me detaje në mënyrën e krijimit të këtyre lidhjeve, ku përfshihet edhe kapja e shtetit.

## Qëllimi i Dokumentit

Diskutimet e shumta mbi oligarkët dhe oligarkinë kanë risjellë në vëmendje nevojën për një trajtim dhe adresim gjithëpërfshirës të kësaj forme qeverisjeje. Sfidat dhe problematikat me të cilat është përballuar Shqipëria gjatë dekadave të fundit e bëjnë po qaq të nevojshëm dhe aktual diskutimin mbi këtë fenomen edhe në Shqipëri.

Si një risi në këtë drejtim, ky dokument politikash ka si qëllim që nëpërmjet të dhënave dhe analizave të referuara të nxjerrë në pah dhe evidentojë praninë dhe ndërthurjen e pushtetit ekonomik dhe politik në jetën publike në Shqipëri.

Bazuar në këto elementë të analizës, dokumenti shënon një përpjekje për të adresuar dhe dhënë përgjigje disa prej pyetja kryesore kërkimore që lidhen me:

- ✓ Cilët janë disa nga treguesit kryesorë, të cilët evidentojnë përqëndrimin në rritje të ekonomisë së vendit tek një grup i ngushtë individësh përgjatë dekadës së fundit?
- ✓ Cilët janë mekanizmat e përdorur për krijimin, mbrojtjen apo zgjerimin e pasurisë përgjatë dekadave të fundit në Shqipëri? Si kanë përfituar nga përdorimi i këtyre mekanizmave një grup individësh për tu pasuruar gjithnjë e më shumë?
- ✓ Sa ndikim kanë patur lidhjet dhe favorizimet politike për të mbështetur dhe forcuar pozitat dhe përfitimet e një grupi të ngushtë dhe të përzgjedhur individësh? Cilët janë sektorët dhe format kryesore të këtij ndikimi?

## Metodologjia & të Dhënat

Përcaktimi i një metodologjie gjithëpërfshirëse ka qenë një sfidë jo e lehtë nisur nga të gjitha kufizimet e përmendura në fillim të këtij seksioni që lidhen me konfuzitetin mbi termin në përgjithësi, shtrirjen e tij si edhe të dhënat e disponueshme.

Pavarësisht kësaj, bazuar në tiparet kryesore të oligarkisë të evidentuara gjatë trajtimeve teorike dhe kritereve të përdorura së fundmi në ligjet për de-oligarkizimin, metodologjia e përcaktuar përfshin 3 komponentë kryesorë: (Tabela 1)

1. Tregues dhe të dhëna
2. Ndikimi dhe lidhjet me politikën
3. Sektorët nëpërmjet të cilëve synohet të zgjerohet pasuria duke krijuar një përqëndrim të lartë të saj

Secilit komponent i bashkëngjitet një tregues, për matjen dhe vlerësimin e të cilëve janë mbledhur të dhënat respektive dhe të cilat përfshijnë:

- Informacione dhe dokumente nga institucionet shtetërore;
- Studime, analiza, raporte kërkimore, dokumente politikash, strategji dhe dokumenta të tjera;
- Databaza dhe analiza sasiore të marra nga website të dedikuara;
- Artikuj në shtyp, deklarata dhe informacione të publikuara nga organizata të ndryshme;
- Të dhëna të tjera dytësore.

<b>Komponentët</b>	<b>Tregues për matje dhe vlerësim</b>		
<b>I. Tregues &amp; të Dhëna</b>	Pabarazia në të ardhura dhe pasuri	Mungesa e konkurrencës	Reduktimi dhe shmangia e taksave
<b>II. Ndikimi dhe Lidhjet Politike</b>	Lidhjet e politikës me biznesin	Financimi i partive politike	Pronësia dhe kontrolli mbi median
<b>III. Mbrojtja, Zgjerimi dhe Përqëndrimi i Pasurisë</b>	Partneritetet Publik Privat (PPP)	Prokurimet Publike (PP)	Investimet Strategjike (IS)

Tabela 1: Komponentët dhe Treguesit e Metodologjisë

## Target Group & Kufizime

Identifikimi i individëve më të pasur<sup>19</sup> si dhe bizneseve më fitimprurëse në Shqipëri<sup>20</sup> mori një vëmendje të shtuar vetëm pas viteve 2000' dhe kryesisht këto nisma u ndërmorrën nga aktorë jo-shtetërorë.

Hartimi i listës me personat më të pasur në Shqipëri u përcaktua për herë të parë si një objektiv në Programin e ri Ekonomik të Qeverisë 2022-2024, me qëllim hetimin e pasurisë së tyre për arsye të mbledhjes së taksave dhe reduktimit të informalitetit.<sup>21</sup> Lista është parashikuar të përmbushet gjatë tre viteve, ku në vitin 2022 u synua listimi i 100 personave më të pasur, ndërkohë që në vitin 2023 parashikohet të listohen 200 persona të tjerë dhe gjatë vitit 2024 edhe 350 individë të tjerë të pasur, duke e çuar listën totale në 650 individë.

Pavarësisht hapave të ndërmarra nga institucionet shtetërore, në kohën e përgatitjes së këtij dokumenti politikash vlerësimi dhe publikimi i një liste me personat më të pasur ka qenë i pamundur.

Me qëllim përzgjedhjen e një target grupi i cili të shërbejë në funksion qëllimeve të këtij dokumenti, analiza e kryer ka marrë në shqyrtim **40 individët më të pasur në Shqipëri** të renditur përgjatë viteve 2014-2017, sipas një metodologjie të bazuar në kritere që lidhen me 1) Kapitalin aksioner dhe pjesët takuese proporcionalisht; 2) Fitimin (proporcional) të vitit ushtrimor; si edhe 3) Kapitalin neto proporcional.<sup>22</sup>

Pavarësisht kufizimeve për të patur një listë sa më gjithëpërfshirëse si pasojë e mungesës së studimeve për vitet vijuese, por edhe vetë metodologjisë së aplikuar, është e rëndësishme të theksohet që kjo përzgjedhje ka synuar të shërbejë si një pikë hyrjeje për t'ju përgjigjur pyetjeve kërkimore që shtrohen në këtë dokument si edhe nxitur ndërmarrjen e studimeve të ardhshme më të hollësishme, nisur kjo edhe nga problematikat që lidhen me disponueshmërinë e të dhënave në këtë drejtim.

**20 individët e parë më të pasur** janë renditur për 4 vitet e marra në shqyrtim (2014-2017) si 10 personat më të pasur në vend, ndërkohë që **20 individët e tjerë më të pasur** janë renditur si të tillë bazuar në kriteret e tjera të metodologjisë së vlerësimit për periudhën referuese (Shtojca A).

<sup>19</sup> Fondacioni për Liri Ekonomike, Albanian Millionaires – Studim për 10 super të pasurit shqiptarë

<sup>20</sup> "Monitor 200 sipas fitimeve": [Speciale Monitor – SIPAS FITIMIT](#)

<sup>21</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë, [Programi i Reformave Ekonomike 2022-2024](#)

<sup>22</sup> Fondacioni për Liri Ekonomike, Albanian Millionaires – Studim për 10 super të pasurit shqiptarë

## Pjesa I: Tregues dhe të Dhëna

Krijimi i biznesmenëve të parë në Shqipëri shpesh është konsideruar një proces problematik nisur edhe nga vetë natyra specifike e transformimeve dhe vështirësive të mëdha që shoqëruan vendin pas viteve 90' duke kaluar nga një ekonomi e planifikuar dhe centralizuar drejt ekonomisë së tregut të lirë, të shoqëruar me reforma radikale ekonomike dhe politike të ndodhura njëkohësisht, si dhe me një mungesë totale informacioni për t'ju përgjigjur saktë dhe në mënyrë efikente këtyre sfidave.<sup>23</sup>

Për pasojë, përveç krizave të njëpasnjëshme dhe me pasoja sociale dhe ekonomike të shoqëruara me kriza të forta politike, ekonomike e sociale, kjo periudhë solli edhe krijimin e të ashtëquajturave “oligarkë”, të cilët duke përfituar nga kaosi i fillimit të reformave dhe paqartësitë në realizimin e tyre, shfrytëzuan nëpërmjet korrupsionit dhe mbështetjes politike burimet e ndryshme për pasurimin e menjëhershëm dhe të dyshimtë të tyre.<sup>24</sup>

Në mënyrë të veçantë, pas dekadës së parë që nga fillimi i tranzicionit (1990-2000), fazë e cila u shoqërua me një recesion të thellë dhe konflikte, fillimi i viteve 2000 përkoi me periudhën gjatë së cilës filluan të bëheshin privatizimet e mëdha dhe strategjike dhe me fitime të larta.

Pavarësisht këtyre tendencave të fillimit, rritja ekonomike nuk ju përgjigj zhvillimit ekonomik të vendit, i cili nënkupton standarde më të larta mirëqenie, ngushtim të pabarazive sociale, zbutje të varfërisë dhe në tërësi një progres ekonomik dhe shoqëror.

Procesi i formimit të pasurisë në Shqipëri solli krijimin e grupeve të polarizuara shoqërore për sa i përket përqendrimit të pasurisë, ndërkohë që pabarazitë kanë ardhur duke u thelluar duke çënuar në të njëjtën kohë edhe kohezionin social.<sup>25</sup>

Shqipëria konsiderohet një vend ku korrupsioni mbetet pengesa kryesore për zhvillimin dhe integrimin e vendit<sup>26</sup> dhe edhe më shqetësues është fakti se thellimi i këtij fenomeni e ka origjinën në mbështetjen apo kontrollin/kapjen e shtetit dhe politikës nga “oligarkët” apo njerëzit e biznesit.

Kjo e ka bërë edhe më të nevojshëm vlerësimin e këtyre fenomeneve nën dritën e një këndvështrimi tjetër që i referohet pyetjes nëse Shqipëria mund të konsiderohet një vend i cili manifeston tiparet e një vendi ku oligarkët gëzojnë tashmë një ndikim të konsiderueshëm politik të përdorur për qëllime përfitimi pasurore.

\*\*\*

Si një pikënisje e rëndësishme në këtë drejtim, **Seksioni I** më poshtë merr në konsideratë dhe analizon disa nga treguesit kryesore që lidhen me: pabarazitë ekonomike, mungesën e konkurrencës dhe pagesat e taksave.

Të vetëdijshëm që këto vlerësime përbëjnë një pjesë të tipareve të vendeve me tipare oligarkike, duhet theksuar fakti se ato mbeten vlerësime mjaft thelbësore dhe të rëndësishme për të kuptuar jo vetëm gjendjen dhe situatën, por në të njëjtën kohë për të vlerësuar ndikimet në politikën dhe qasjet e ndërmarra në drejtim të privilegjimit ose jo të grupeve të caktuara me burime mëdha financiare dhe pasurore.

<sup>23</sup> Botal.al, Adrian Civici [“Tranzicioni i vështirë i Shqipërisë, nga ekonomia e centralizuar, drejt ekonomisë së tregut. Analiza e Prof. Adrian Civicit”](#), Shtator 2019

<sup>24</sup> Po aty

<sup>25</sup> Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana, Selami Xhepa, Adrian Civici [“Sistemi Ekonomik dhe Roli i Shtetit në Shoqëri: Opinioni dhe Qendrimet e Publikut Shqiptar”](#) (2021)

<sup>26</sup> Komisioni Evropian, [Raporti Vjetor 2022 i Komisionit Evropian për Shqipërinë](#), 12 Tetor 2022

## Pabarazia në të Ardhura dhe Pasuri

Pabarazia në të ardhura dhe pasuri është një nga çështjet kryesore që diskutohet në kuadër të zhvillimit ekonomik të një vendi, ndërkohë që vitet e fundit ky debat është përforcuar edhe më shumë nisur nga dallimet e theksuara dhe në rritje ndërmjet individëve më të pasur krahasimisht me të tjerët.


Edhe në raste të situatave të jashtëzakonshme siç ishte pandemia e COVID-19 pabarazitë ndërmjet të pasurve dhe pjesës tjetër janë thelluar edhe më tej, duke bërë që të pasurit të pasurohen më shumë dhe të varfërit të varfërohen më shumë.<sup>27</sup>

Edhe në Shqipëri mund të evidentohet një tendencë në rritjen e pabarazisë, ku 1% e popullsisë merr rreth 9% të të ardhurave, ndërkohë 10% e popullsisë merr më shumë se 1/4 (34%) të të ardhurës kombëtare të krijuar.

50% e popullsisë që ndodhet në fundin e piramidës së shpërndarjes së të ardhurave merr rreth 19% të të ardhurave, ose rreth 2 herë më pak se 10% që janë në majë të piramidës.

Publiku ka qartazi një perceptim se shpërndarja e pasurisë dhe e të ardhurave ka krijuar pabarazi të mëdha dhe se kjo përbën një shqetësim serioz për kohezionin social. Po ashtu, një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve mendojnë se pasuria e krijuar nga të pasurit nuk është vënë me anë të punës së ndershme.<sup>28</sup>

**Grafik 1: Pabarazia në të Ardhura (2000 - 2021)**



*Burimi i të dhënave: World Inequality Database*


*Përpunimi i të dhënave: Autori*

Në lidhje me të dhënat që lidhen me pabarazinë në pasuri, 1% e popullsisë zotëron rreth 23% të pasurisë dhe 10% rreth 57% të pasurisë. Nga ana tjetër 50% e popullsisë që ndodhen në fundin e piramidës zotëron vetëm 5% të pasurisë ose rreth 10 herë më pak se 10% që janë në majë të piramidës.

<sup>27</sup> OXFAM, "The Inequality virus", (2021)

<sup>28</sup> Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana, Selami Xhepa, Adrian Civici "Sistemi Ekonomik dhe Roli i Shtetit në Shoqëri: Opinioni dhe Qendrimet e Publikut Shqiptar" (2021)


**Grafik 2: Pabarazia në Pasuri (2000 - 2021)**



*Burimi i të dhënave: World Inequality Database  
Përpunimi i të dhënave: Autori*

Edhe indeksi i koeficientit Gini,<sup>29</sup> i cili mat pabarazinë përgjatë gjithë shoqërisë (jo vetëm duke krahasuar të ardhurat e grupeve të ndryshme) ka një vlerë të lartë, në rreth 33%. E parë në një kontekst krahasues, kjo vlerë e indeksit të koeficientit Gini, e rendit Shqipërinë ndër vendet me nivele të larta pabarazie, krahas vendeve si Britania e Madhe apo Spanja.<sup>30</sup>

**Grafik 3: Indeksi i koeficientit Gini, 1996–2017**




*Burimi i të dhënave: World Inequality Database  
Përpunimi i të dhënave: Autori*

<sup>29</sup> Indeksi Gini ose Koeficienti Gini mat shpërndarjen e të ardhurave, apo shpërndarjen e pasurisë në popullsinë e një vendi e më gjerë. Koeficienti shkon nga 0 (ose 0%) në 1 (ose 100%), ku me 0 kuptohet barazia perfekte dhe me 1 kuptohet pabarazia në nivelet më të larta.

<sup>30</sup> Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana, Selami Xhepa, Adrian Civici [“Sistemi Ekonomik dhe Roli i Shtetit në Shoqëri: Opinioni dhe Qendrimet të Publikut Shqiptar”](#) (2021)

Nga ana tjetër edhe pasuritë monetare të depozituesve më të mëdhenj në sektorin bankar në Shqipëri kanë shënuar rritje. Bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, 10 depozituesit më të mëdhenj zotëronin gjatë vitit 2021, 10.5% të totalit të depozitave bankare nga rreth 7.4% që zotëronin në vitin 2020.<sup>31</sup> Rritje të totalit të depozitave bankare shënuan përgjatë vitit 2021 edhe 20 dhe 50 depozituesit më të mëdhenj në Shqipëri. Këto shifra tregojnë se më të pasurit kanë vazhduar të rrisin pjesën e pasurisë të mbajtur në formën paraje në sektorin bankar.


**Grafik 4: Pesha e Depozituesve më të Mëdhenj ndaj Totalit të Depozitave Bankare (%)**



*Burimi: Banka e Shqipërisë, Raportet Vjetore të Mbikqyrjes  
Përpunimi i të dhënave: Autori*

Edhe në raportin vjetor të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2021, ishin 109,192 ndërkohë që shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 646 mld lekë, krahasimisht me një vit më parë ku depozituesit individë me depozita më të mëdha se 2.5 mln lekë në fund të dhjetorit 2020, ishin 101,191 dhe shuma e depozitave të tyre arriti vlerën 585.4 mld lekë.<sup>32</sup> Depozitat e siguruar të tregtarëve dhe shoqërive tregtare gjatë vitit 2021 rezultojnë të jenë rritur me 21%.

**Grafik 5: Pesha e Depozituesve Individëve dhe Shoqërive Tregtare ndaj Totalit të Depozitave Bankare**



*Burimi: Agjencia e Sigurimit të Depozitave  
Përpunimi i të dhënave: Autori*

<sup>31</sup> Banka e Shqipërisë, [Raportet Vjetore të Mbikqyrjes](#)

<sup>32</sup> Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), [Raportet Vjetore](#)




## Mungesa e Konkurrencës

Zhvillimi i konkurrencës së padrejtë dhe përqëndrimi i tregut në vetëm disa biznese kryesore të mëdha, është konsideruar gjithashtu një nga shqetësimet e vazhdueshme dhe më të dëmshme për klimën e biznesit në Shqipëri,<sup>33</sup> ndërkohë që mbrojtja e konkurrencës së lirë është një nga kriteret thelbësore në procesin e integritimit të vendit.

Sipas Indeksit Herfindahl-Hirschman,<sup>34</sup> i cili përdoret gjerësisht në vlerësimin e tregjeve ekonomike për të njohur dhe vlerësuar riskun për pozita dominuese të një apo më shumë firmave në treg, Shqipëria rezulton të ketë një përqëndrim të moderuar (apo mesatar) të tregut, ndërkohë që përgjatë viteve 2000-2010 përqëndrimi i tregut ka rezultuar i lartë.

Ajo çfarë evidentohet është gjithashtu fakti se tregjet në të cilat përqëndrimi është më i madh përbëjnë edhe sektorët më fitimprurës, të cilët zotërohen nga individët më të pasur në vend dhe që lidhen kryesisht me tregun telefonik,<sup>35</sup> median<sup>36</sup> apo hidrokarburet.<sup>37</sup> Nga ana tjetër, pavarësisht problematikave të evidentuara, roli i Autoritetit të Konkurrencës është konsideruar pasiv.<sup>38</sup>

**Grafik 6 : Indeksi i Përqëndrimit të Tregut HH, 2000–2020**



*Burimi i të dhënave: WITS – Country Profile*

*Përpunimi i të dhënave: Autori*

<sup>33</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH), [Raportin mbi Klimën e Investimeve në Shqipëri 2022](#)

<sup>34</sup> Indeksi ka një interval rezultatesh nga 0 deri në 10000 (0 është rezultat i pamundur, kurse 10000 është rasti kur tregu ka vetëm një firmë të vetme, pra rasti i monopolit). Rezultati nga 0 – 1500 tregon se tregu specifik ka një nivel të lartë konkureshmërie, rezultati 1500 deri 2500, tregon që kemi një treg mesatarisht të përqëndruar dhe nëse rezultati është më i madh se 2500, kemi rastin kur tregu është shumë i përqëndruar. Kjo do të thotë që e gjithë fuqia e tregut ndahet midis shumë pak firmave.

<sup>35</sup> Monitor.al, [Celularët, operatori dominues po e rrit më shumë pjesën e tregut këtë vit](#), 25 Dhjetor 2020

Reporter.al, [Autoriteti i Konkurrencës miraton duopolin në tregun e telefonisë celulare](#), 9 Mars 2022

<sup>36</sup> Reporter.al, [Tregu i televizioneve shënon rritje dhe thellon përqëndrimin](#), 2 Shtator 2019

<sup>37</sup> Top Channel, [Bordi i naftës, treg oligopol! Ekspertët: Po nxitet kontrabanda. Anëtarët e bordit të merren nën hetim](#), 5 Dhjetor 2022

Open Data Albania, [Përqëndrimi i tregut të hidrokarbureve në Shqipëri sipas Indeksit Herfindahl-Hirschman](#), 25 Mars 2022

<sup>38</sup> Euronews Albania, [Autoriteti i konkurrencës 'pa autoritet', nuk ka vjelë asnjë gjobë në 3 vjet](#), Maj 2022


## Reduktimi dhe Shmangia e Taksave

Shmangia e taksave nga të pasurit përbën tashmë një çështje mjaft të debatuar edhe në vende të zhvilluara.<sup>39</sup> Në Shqipëri, tatimi mbi dividendin paguhet nga aksionerët e korporatave dhe pronarët e kompanive në masën 8% të vlerës së fitimit të shpërndarë në momentin që ata tërheqin fitimet nga biznesi i tyre. Megjithatë, norma e tatimit për të ardhurën dividend (e ardhur e individit biznesmen) vlerësohet e ulët, krahasuar me vende të tjera të rajonit, në vitin 2015 kjo normë tatimi u bë 8% nga 15% duke u aplikuar edhe me efekte prapavepruese.

Ulja e tatimit mbi dividendin nga 15% në 8% shkaktoi debate të forta jo vetëm politike, por edhe në publik, duke u konsideruar një masë e cila favorizon bizneset dhe të pasurit,<sup>40</sup> të cilët paguajnë më pak taksa për të ardhurat që sigurojnë nga korporatat e tyre. Në vitin 2020 Presidenti i Republikës bëri një kallzim penal në lidhje me ndryshimet e vitit 2018 në Ligjin për Dividentin të rikthyer për shqyrtim,<sup>41</sup> duke e konsideruar uljen e tatim fitimit nga 15% në 8% një mjet favorizues për oligarkët. Kompanitë e mëdha në Shqipëri rezultojnë të kenë ulur taksat që i paguanë shtetit, ndërkohë që më shumë taksa janë mbledhur nga kompani të vogla.<sup>42</sup>

Nga ana tjetër, një problematikë me të cilët është përballur Shqipëria janë parajsat fiskale<sup>43</sup> nga të cilat shuma të konsiderueshme kanë hyrë në Shqipëri<sup>44</sup> si edhe një numër i madh kompanish që operojnë në vend janë regjistruar në parajsa fiskale duke përfutur favore nga paratë publike.<sup>45</sup> Nga ana tjetër vendet anëtare të Bashkimit Evropian rikthyen Shqipërinë në listën e vendeve që duhet të mbahen në monitorim për çështje fiskale.<sup>46</sup>

**Grafik 7: Të ardhura nga Dividenti në Milion Lekë**



*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
Përpunimi i të dhënave: Autori*

<sup>39</sup> Zëri i Amerikës, [Amerikanët e pasur i shmangen pagesës së 175 miliardë dollarëve në taksa](#), Mars 2021  
Reporter.al, [Dosjet sekrete zbulojnë se si miliarderët shmangin taksën mbi të ardhurat](#), 14 Qershor 2021

<sup>40</sup> Revista Monitor, [Ironia e Ramës me bizneset VIP, u fali 65 mln euro dhe u kërkoi të japin për të varfërit 4 mln euro](#), Tetor 2019

<sup>41</sup> Presidenti i Republikës, [Presidenti Meta dekreton kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 94/2018 – Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit](#), Dhjetor 2018

<sup>42</sup> Top Channel, [Të mëdhenjtë paguajnë më pak/ Tatimet mblodhën me shumë taksa nga më të vegjëlit](#), 21 Prill 2022

<sup>43</sup> Reporter.al, [Pyetje-përgjigje për parajsat fiskale](#)

<sup>44</sup> Euronews Albania, [179 mln euro hynë në Shqipëri nga parajsat fiskale gjatë vitit 2021](#), 20 Prill 2022

<sup>45</sup> - RTSH 24, [Brahaj: 700 kompani që operojnë në vend, të regjistruara në parajsa fiskale](#), 2 Shkurt 2023

- Sot.com.al, [Paketa fiskale, Tabaku: 130 mln euro që qeveria do marrë nga familjet shqiptare, 90% shkojnë për klubin e oligarkëve](#), 31 Tetor 2022

- Abcnews.al, [FMN zbardh skemën: Si të zbulohen dhe taksohen shqiptarët e pasur që depozitojnë në parajsat fiskale](#), 23 Maj 2022

<sup>46</sup> Reporter.al, [Shqipëria nën monitorim nga BE për "mosbashkëpunim fiskal"](#), 15 Shkurt 2023

## Pjesa II: Ndikimi dhe Lidhjet Politike

Pavarësisht përpjekjeve të bëra ndër vite, Shqipëria ende vazhdon të konsiderohet një vend ku ndikimi i lidhjeve politike e bën të pamundur pavarësinë dhe funksionimin eficient të një sërë sektorësh kyç për zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Përfshirja dhe lidhjet e politikanëve në Shqipëri me krimin dhe korrupsionin do të sillnin një sërë pasojash dhe vonesash edhe në procesin e integritetit të vendit.

Miratimi i një reforme gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë në korrik të vitit 2016 përbën ndoshta një nga rastet dhe shembujt më ekstremë të këtij ndikimi. Në mënyrë të veçantë ngritja dhe funksionimi i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar do të ishte një nga qëllimet kryesor të reformës dhe pritshmëritë e publikut do të ishin të larta si pasojë e gjendjes së krijuar dhe përfshirjes së funksionarëve të lartë në afëra të mëdha korruptive.

Gjatë viteve të fundit edhe më shqetësues do të bëhej fakti i përfshirjes në këto afëra për qëllimi përfitimi dhe pasurimi në forma të paligjshme i individëve të njohur edhe nga sektori i biznesit, të vënë në qendër të vëmendjes si pasojë e ndikimit dhe mbështetjes politike.<sup>47</sup>

Pavarësisht akuzave të ndërsjellta, është e vështirë të përcaktosh në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të dallueshme se cila nga palët (politika apo biznesi) ka patur ndikim më të madh apo ka luajtur një rol më kryesor në formësimin e këtyre proceseve të dekadave të fundit, të cilat kanë kontribuar në forcimin e këtyre lidhjeve dhe interesave me qëllim kapjen dhe shfrytëzimin e burimeve dhe pasurive shtetërore.

Çfarë mbetet ende e evidente është fakti që politika në Shqipëri vazhdon të ketë një ndikim në formësimin e mënyrës se si zhvillohet modeli i biznesit në Shqipëri, ndërkohë që mungesa e vullnetit politik përbën një nga pengesat serioze për të shpënë përpara procese të rëndësishme në mënyrë që të sigurohet një shkëputje e nevojshme e të gjitha hallkave dhe lidhjeve të cilat pengojnë transparencën.<sup>48</sup>

Megjithëse më pak i paraqitur, po kaq i rëndësishëm është edhe ndikimi që grupe të caktuara dhe me interesa specifike kanë mbi politikën dhe politikanët. Intensifikimi i këtyre marrëdhënieve përgjatë dy dekadave të fundit, ka krijuar një rreth vicioz, duke e bërë edhe më të përqëndruar shfrytëzimin e favoreve dhe përmbushjen e interesave të caktuara ekonomiko-financiare.

\*\*\*

Ky **Seksion i II** i këtij dokumenti politikash, përshkruan dhe trajton disa nga sferat më të rëndësishme të jetës politike dhe ekonomike në Shqipëri, në të cilat dinamikat e ndikimit dhe influencës politike kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol kryesor.

<sup>47</sup> Ambasada e SHBA në Shqipëri, [Thesari Shënjestron Aktorë për Sjellje Destabilizuese në Mbarë Ballkanin Perëndimor](#), 11 Prill 2022

<sup>48</sup> Zëri i Amerikës, [“Dekriminalizimi” në Shqipëri, Fenomeni që vazhdon të prodhojë debate](#), Tetor 2019

## Lidhjet e politikës me biznesin dhe përfshirja e biznesmenëve në politikë

Lidhjet e krijuara ndërmjet politikës dhe biznesit përbëjnë rastin më qartë që përdorin oligarkët me qëllim shfrytëzimin e lidhjeve politike me qëllim krijimin, mbrojtjen apo zgjerimin e pasurisë materiale të tyre. Përgjatë periudhave zgjedhore, gjithnjë e më shumë është evidentuar një rritje e përfshirjes së biznesmenëve në politikë. Në zgjedhjet e vitit 2013 u evidentua një numër i lartë i biznesmenëve të fuqishëm për të konkurruar dhe fituar në legjislaturën e zgjedhjeve të kohës.<sup>49</sup>

Ndërkohë që edhe parlamenti u dominua nga biznesmenë, të cilët përbënë rreth 26% të parlamentit ose më shumë se një të katërtën e të gjithë deputetëve. Disa prej tyre janë biznesmenë me ndikim të madh në ekonomi, posedojnë firma të njohura dhe asete të mëdha financiare, disa të tjerë kanë biznese të mesme, në fushën e konsumit dhe të shërbimeve publike. Numri i madh i biznesmenëve të cilët përfshihen në politikë është konsideruar se nxjerr në pah ndër të tjera edhe konfliktin që krijohet në Parlament në lidhje me miratimin e akteve ligjore, nisur nga interesat e tyre për ligje specifike.

Nevoja që kanë partitë politike për të siguruar mbështetje financiare gjatë fushatave zgjedhore dhe potenciali financiar i jep mundësinë komunitetit të biznesit të bëhet faktor i rëndësishëm në zgjedhje. Kjo është një praktikë e zakonshme, dhe për shkak të sistemit zgjedhor në Shqipëri kjo praktikë inkurajon një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis komunitetit të biznesit dhe udhëheqësit të partisë, çka përcakton edhe listën e kandidatëve.<sup>50</sup>

## Financimi i Partive Politike

Financimi i partive politike përbën një nga mënyrat më të diskutuara nëpërmjet së cilës, biznesmenë apo individë me pushtet ekonomik kërkojnë të vendosin dhe ushtrojnë ndikimin e tyre tek politikanë në këmbim të favoreve dhe përfitimeve personale, ndërkohë që vitet e fundit ky shqetësim konsiderohet një çështje me rrezikshmëri në rritje.

Edhe pse gjatë fushatave politike janë hasur vazhdimisht shpenzime marramendëse, të cilat nuk përputhen me vetëdeklarimet e partive politike, apo vetë buxhetin e financuar nga shteti, raportimi i këtyre të fundit vazhdon të mbetet formal dhe sipërfaqësor, pavarësisht fshehjes së shpenzimeve. Mungesa e transparencës dhe sistemi informal i financimit të partive politike dhe fushatave elektorale është një fenomen i mbartuar përgjatë dy dekadave të tranzicionit në Shqipëri, i evidentuar në shumë raste nga organizatat ndërkombëtare.

Pavarësisht kërkesave për vendosjen e rregullave të financimit të partive politike, nisur edhe nga kritikrat e shpeshta ndaj rolit monitorues dhe hetues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,<sup>51</sup> kontrolli dhe monitorimi i fushatave zgjedhore bëhet nëpërmjet vetëdeklarimit të partive politike, ndërkohë që KQZ nuk ka autorizim për të kryer hetime të mëtejshme. Roli i këtij institucioni vazhdon të jetë formal bazuar vetëm në raportet e dorëzuara nga partitë politike dhe verifikimi formal i vetëdeklarimeve të kryera.

Në këtë mënyrë, akuzat për lidhje kriminale me përfaqësues politikë apo futjen e parave të pista në periudha fushatash zgjedhore kanë dominuar skenën politike në vend, duke krijuar në këtë mënyrë një mjedis të favorshëm edhe për përfshirjen e biznesmenëve apo edhe të personave me një të shkuar të errët në listat e kandidatëve për deputetë.

Shqipëria u rendit e treta nga vendet e BERZH, pas Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjës ku lidhjet politike prevalojnë në suksesin e bizneseve. 43% e firmave të anketuara në Shqipëri janë përgjigjur se lidhjet me politikën garantojnë ecurinë pozitive të aktivitetit, në një kohë që në vendet e tjera të rajonit dhe në ato në zhvillim përqindja e bizneseve që mendojnë në këtë mënyrë është shumë më e ulët.<sup>52</sup>

<sup>49</sup> BTI 2018 Country Report, [https://bti-project.org/fileadmin/api/content/en/downloads/reports/country\\_report\\_2018\\_ALB.pdf](https://bti-project.org/fileadmin/api/content/en/downloads/reports/country_report_2018_ALB.pdf)

<sup>50</sup> Westminster Foundation for Democracy (WFD), [Making running for office more affordable in Albania](#), 26 Shtator 2019

<sup>51</sup> Reporter.al, [KQZ i rekomandon Kuvendit vendosjen e rregullave për financimin e partive politike](#), 5 Tetor 2022

<sup>52</sup> The European Bank for Reconstruction and Development, ["Life in Transition Survey \(LITS\)"](#)

## Pronësia dhe Kontrolli mbi Median

Presioni dhe kontrolli mbi mediat dhe gazetarët përbën gjithashtu një nga mënyrat e përdorura nga individët me pushtet financiar për të manipuluar aktivitetet si edhe lidhjet e tyre me politikën. Për arritjen e këtij qëllimi janë përdorur forma nga më të ndryshmet të cilat kanë përfshirë jo vetëm korrupsionin e individëve të caktuar në botën e medias dhe shtypit, por edhe ofrimin e favore të tjera me përfitime ekonomike.

Përveçse anësive në informim dhe mungesës së profesionalizimit, kjo situatë ka krijuar ndër vite një përqëndrim gjithnjë e më në rritje të tregut të medias në duart e një grupi të vogël individësh të pasur për shkak të lidhjeve politike dhe për rrjedhojë një kontrolli të theksuar mbi të gjitha organet e shtypit.

Në vitin 2021 Shqipëria u rendit në vendin e 103 nga 180 vende në Indeksin e Lirisë së Medias të hartuar nga organizata Reporterët pa Kufij, duke rënë 20 pozicione si pasojë e situatës së përkeqësuar nga kërcënimet e pavarësisë editoriale, cënimin e integritetit fizik të gazetarëve nga krimi i organizuar dhe dështimin e shtetit shqiptar për t'i mbrojtur gazetarët edhe nga dhuna policore.<sup>53</sup>

Sipas raportit, mediat private shqiptare më me ndikim zotërohen nga një pjesë e vogël e kompanive që kanë lidhje me politikanët, ndërsa operojnë në të njëjtën kohë në sektorë të tjerë sikurse ndërtimi. Raporti thekson se vetëm një pakicë e vogël e mediave ka një model biznesi të qëndrueshme dhe financim transparent.

Edhe Monitori i Pronësisë së Medias (MOM) i përgatitur nga Reporterët pa Kufinj dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) evidenton se shumica e mediave janë nën pronësinë e një grushti familjesh të fuqishme, ndërsa pjesa tjetër është e lidhur ngushtë me biznesmenë që operojnë në tregje të rregulluara, më së shumti në ndërtim dhe zhvillim pronash të patundshme, në arsimin e lartë, banka dhe lojërat e fatit.<sup>54</sup> Pronësia e medias në Shqipëri është një biznes familjar, teksa tregu është shumë i përqëndruar në duart e pak familjeve të fuqishme.<sup>55</sup>

Pronarë të autorizuar, shpesh nga rrethi i ngushtë ose i zgjeruar familjar përdoren për të ruajtur kontrollin/ndikimin mbi median ose biznese të tjera. Forcat politike e përdorin dhe e shpërdorjnë median për të manipuluar raportimin apo për ta zhvlerësuar atë. Për të qëndruar në treg ose për të siguruar fitime (përmes koncesioneve, licensave, subvencioneve shtetërore) në këtë mjedis, pronarët inkurajohen që mbajnë lidhje të ngushta me forcat politike, të cilat për median nënkuptojnë kompromentimin e mbulimit të pavarur mbi çështjet sociale, ekonomike dhe politike.<sup>56</sup>

Sipas raportit të Monitorimit të Pluralizmit të Medias (MPM) në epokën digitale të përgatitur nga Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias (CMPF), Shqipëria ka një nivel shumë të lartë të përqendrimit të medias në tregun e medias audiovizive, ndërkohë që interesat ekonomike të pronarëve të medias në tregje shumë të rregulluara e vendosin median shqiptare nën ndikim politik.<sup>57</sup>

<sup>53</sup> Reporters without Borders, [World Press Freedom Index 2022](#)

<sup>54</sup> Global Media Registry (GMR) & BIRN ALBANIA, [Monitori i Pronësisë së Medias \(MOM\) Shqipëri 2018](#)

<sup>55</sup> Po aty

<sup>56</sup> Po aty

<sup>57</sup> Qendra për Pluralizmin e Medias dhe Lirinë e Medias, [Monitorimi i pluralizmit të medias në epokën digitale](#), Korrik 2021

## Pjesa III: Mbrojtja, Zgjerimi dhe Përqëndrimi i Pasurisë

Megjithë problematikat dhe vështirësitë që shoqëruan kalimin e ekonomisë së centralizuar drejt një ekonomie tregu në fillim të viteve 1990', edhe pas 30 vitesh Shqipëria duket se do ta kishte të vështirë të krijonte një model të qëndrueshëm ekonomik, i cili të gjeneronte një zhvillim të suksesshëm në drejtim të rritjes cilësore ekonomike, uljes së borxhit publik, infomalitetit dhe papunësisë.

Ky model i ekonomisë përgjatë viteve në vijim do të krijonte një sërë fenomesh problematike të tilla si një mjedis jokonkurrues, në shumë raste favorizues për një pakicë, pak investime në teknologji e orientim nga importi, infomalitet në tregun vendas, mungesë të investimeve të huaja cilësore, paga ndër më minimalet në Europë si edhe ritme të larta të emigracionit.<sup>58</sup>

Në këtë kontekst, disa vite më parë, Banka e Shqipërisë do të shprehej publikisht lidhur me nevojën për të ndërtuar një model të ri ekonomik për Shqipërinë dhe thuajse një dekadë më vonë edhe Banka Botërore do të vlerësonte se rritja e ardhshme e Shqipërisë kërkon një model më të fortë dhe më të qëndrueshëm ekonomik me investime më të mëdha në katër fusha kryesore aftësimin e kapitalit njerëzor, produktivitetin e firmave, qëndrueshmërinë si dhe financat publike".<sup>59</sup>

Për një vend si Shqipëria me pabarazi të papërfillshme në fillimet e tranzicionit, në një model të tillë ekonomik pabarazitë erdhën duke u thelluar. Procesi i krijimit të pasurisë solli formimin e grupeve të polarizuara shoqërore për sa i përket përqendrimit të pasurisë ku veçanërisht pas viteve 2000' do të vërehej një vëmendje të shtuar ndaj individëve më të pasur<sup>60</sup> si edhe kompanive më fitimprurëse në vend.<sup>61</sup>

Por ajo që mund të konsiderohet problematike edhe sot, është fakti se pjesa më e madhe e këtyre kompanive janë bazuar në modele "dembela" biznesi me fitime të garantuara nga shteti duke shmangur shpesh konkurrencën.<sup>62</sup> Kanalizimi i parave sipas këtij modeli skemash ka shtrembëruar konkurrencën, ndërkohë që ato kanë rezultuar korruptive, me kosto të larta për shtetin dhe përfitime të vogla për publikun duke dekurajuar investimet në sektorët e tjerë produktivë.<sup>63</sup>

\*\*\*

Ky **Seksion i III** i këtij dokumenti politikash fokusohet në një vlerësim të të dhënave nëpërmjet të cilave përshkruhet procesi se si pasuria materiale është përqëndruar në një grup të vogël individësh, dhe se si ky përqëndrim ka patur tendencën për të shpënë me kalimin e kohës jo vetëm në mbrotjen e këtyre burimeve, por edhe në zgjerimin e tyre, nëpërmjet lidhjeve klienteliste, korruptive dhe favorizuese.

<sup>58</sup> Revista Monitor, [200 VIP-at e vitit 2021. Rreziqet pas rimëkëmbjes së shpejtë](#), Shtator 2022

<sup>59</sup> World Bank Group, ["Albania Country Economic Memorandum : Strengthening the Sustainability of Albania's Growth Model"](#) (2021)

<sup>60</sup> Fondacioni për Liri Ekonomike, Albanian Millionaires – Studim për 10 super të pasurit shqiptarë

<sup>61</sup> "Monitor 200 sipas fitimeve": [Speciale Monitor – SIPAS FITIMIT](#)

<sup>62</sup> Revista Monitor, [200 kompanitë me fitime më të mëdha; Koncesionet dhe ndërtimi më fitimprurëset në ekonomi](#), Nëntor 2021

<sup>63</sup> Po aty


## Partneritetet Publik Privat (PPP)

Megjithëse të përcaktuara si një formë partneriteti ndërmjet palës publike dhe asaj private në ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike duke ndikuar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, koncesionet kanë qenë një nga problematikat më të mëdha në rastin e Shqipërisë. Me ndryshimet politike të cilat ndodhën në Shqipëri gjatë viteve 90' përdorimi i praktikës së partneritetit publik privat (PPP) u konsiderua si një metodë alternative dhe e leverdisshme në ofrimin e punëve dhe shërbimeve publike të cilat u trajtuan fillimisht në formën e koncesioneve.

Në Shqipëri koncepti i koncesioneve është parashikuar më herët nga legjislacioni venda<sup>64</sup> krahasuar me konceptin e Partneritetit Publi Privat (PPP-të), i konsideruar si një koncept më i gjerë i koncesioneve me qëllim për t'ju përshtatur praktikave të biznesit si edhe qasjeve ndërkombëtare mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat.<sup>65</sup> Për shkak të kompleksitetit dhe risqeve të kontratave koncesionare, kostove buxhetore dhe fiskale, por edhe numrit të lartë të kontratave të miratuara ndër vite në Shqipëri, monitorimi mbi ecurinë e zbatimit të kontratave përbën një nga elementët më të rëndësishëm të transparencës.

Aktualisht, procesi i monitorimit të kontratave të koncesioneve/PPP dhe raportimit nga Autoritetet Kontraktuese ka filluar për herë të parë në muajin mars të vitit 2019,<sup>66</sup> proces ky i cili realizohet sipas formateve, procedurave dhe afateve respektive.<sup>67</sup> Por pavarësisht rëndësisë së sigurimit të transparencës që mbetet një nga komponentët më të rëndësishëm të monitorimit të kontratave koncesionare, ende Raporti i Monitorimit për vitin 2021 nuk është bërë publik.<sup>68</sup>

**Grafik 8: Numri Total i Projekteve me Koncesione/PPP të miratuara ndër vite, 2004-2022**



*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Pjesa më e madhe e ekspertëve kanë theksuar se numri i kontratave koncesionare për një vend si Shqipëria është tepër i lartë, ndërkohë që zbatimi i këtyre kontratave është shoqëruar nga një sërë sfidash dhe problematikash, ndër të cilat mospërbushja e qëllimeve afatgjata dhe standardeve ndërkombëtare, mungesa e konkurrencës dhe transparencës, moskryerja e shërbimeve, etj.<sup>69</sup>

<sup>64</sup> Ligj nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", zëvendësuar nga Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për Koncesionet"

<sup>65</sup> Ligj Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat, ndryshuar me Ligjin Nr.50 datë 18.07.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat"

<sup>66</sup> Udhëzim plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019". Seksioni IV, Pika 121/paragrafi 2

<sup>67</sup> Udhëzim i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.35, datë 12.12.2019

<sup>68</sup> Reporter.al, "[Ministria e Financave dështon të publikojë raportin e performancës së koncesioneve](#)", Korrik 2022

<sup>69</sup> Business Magazine, "[Enio Jaço: Pse dështojnë koncesionet?!](#)", Mars 2022

Ritja e numrit të kontratave koncesionare cilësohet në se ka reduktuar mundësitë për konkurrencë,<sup>70</sup> përfshirë investimet e huaja në infrastrukturë dhe sektorë të tjerë.<sup>71</sup>

Përveç këtyre sfidave ajo çfarë është evidentuar problemtike gjatë zbatimit të këtyre kontratave koncesionare kanë qenë abuzimet si edhe lidhjet klienteliste dhe korruptive të subjekteve që kanë fituar këto kontrata,<sup>72</sup> ndërkohë që ekspertët kanë kërkuar pezullimin e këtyre kontratave.<sup>73</sup>

Deri në fund të vitit 2022 kanë rezultuar aktive 11 kontrata koncesionare të financuara nga buxheti i shtetit, 7 prej të cilave arrijnë vlerën e kontratës në mbi 5,000,000,000 Lekë. Thuajse zbatimi i të gjitha këtyre kontratave ka rezultuar problematik duke nxjerrë në pah afërsisht korruptive dhe klienteliste.

Sektori i shëndetësisë është konsideruar një nga sektorët me numër të lartë të kontratave koncesionare (4 të tilla) duke shpënë në përqëndrim të lartë të tregut spitalor si dhe ndryshuar ndjeshëm kushtet e tregut të shëndetit në Shqipëri.<sup>74</sup> Dy nga kontratat në këtë sektor janë aktualisht në hetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Kontrata koncesionare e check-up, e cila u riaktivizuar pas pezullimit për shkak të situatës së krijuar nga pandemia ka rezultuar problematike në moskryerjen e shërbimeve të caktuara dhe kostove të larta në dëm të taksapaguesve.<sup>75</sup>

Nga ana tjetër, edhe koncesioni i laboratorëve mjekësorë, kontrata e katërt e partneritetit publik-privat në sektorin e shëndetësisë gjithashtu në hetim nga SPAK është cilësuar si një shërbim në kundërshtim me ligjin, zbatimi i së cilës ka sjellë gjithashtu pasojat për pacientët dhe sistemin shëndetësor.<sup>76</sup> Koncesioni i hemodializës përveçse ka rezultuar abuziv dhe me shërbime të pakryera<sup>77</sup> origjina e kompanive fituese ka rezultuar e dyshimtë.<sup>78</sup>

Afera e kontratave të inceneratorëve të Tiranës, Elbasanit dhe Fierit përbëjnë gjithashtu një nga rastet më problematike që lidhen me zbatimin e kontratave koncesionare si pasojë e lidhjeve klienteliste dhe korruptive të subjekteve fituese të këtyre kontratave madje qysh në fillimet e tyre.<sup>79</sup>

Në shtator 2021 Kuvendi miratoi ngritjen e komisionit hetimor për inceneratorët,<sup>80</sup> i cili nisi punën në nëntor<sup>81</sup> ndërkohë që në shkurt 2022 komisioni mbylli hetimet.<sup>82</sup> Procesi u shoqërua me një sërë arrestimesh duke përfshirë edhe funksionarë të niveleve të larta. Nga ana tjetër rasti i kontratave të inceneratorëve përveç kostove ekonomike ka krijuar rreziqe që lidhen me mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve.

Zbatimi i kontratave të tjera koncesionare ka rezultuar problematik në kryerjen e shërbimeve të caktuara,<sup>83</sup> ndërkohë që koncesione të tjera me financim nga buxheti i shtetit janë konsideruar si raste tipike të kapjes së shtetit nga interesa private,<sup>84</sup> duke u pritur edhe me protesta të dhunshme, të cilësuar edhe si kryengritje kundër oligarkisë.<sup>85</sup> Nga ana tjetër duke se krijimi i një kulture abuzive dhe korruptive thjesht i ka paraprirë mënyrës se si procese të rëndësishëm ku përfshihen edhe PPP-të do të përfitoheshin dhe zbatoheshin në dëm të interesave publike.<sup>86</sup>

<sup>70</sup> Ornella Liperi, [“Struktura jo produktive e ekonomisë shqiptare dhe normat e larta të fitimit të koncesionarëve”](#)

<sup>71</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, [2022 Investment Climate Statements: Albania](#)

<sup>72</sup> Kuvendi i Shqipërisë, [Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”](#), Mars 2022

<sup>73</sup> Reporter.al, [Pagesat për inceneratorët, ekspertët sugjerojnë pezullim të kontratave koncesionare](#), 6 Janar 2022

<sup>74</sup> Reporter.al, [Qeveria injoron kritikën dhe firmos koncesionin e katërt në shëndetësi](#), 27 Prill 2019

<sup>75</sup> Reporter.al, [Check Up-i falas me fitime të majme: shqiptarët e paguan dyfish në 2015](#), 15 Prill 2017

<sup>76</sup> Reporter.al, [Koncesioni i laboratorëve mjekësorë nën hetim për korrupsion](#), 1 Korrik 2022

<sup>77</sup> Euronews Albania, [Abuzime me koncesionin e dializës, KLSH: 600 mijë € pagesa për shërbime të pakryera](#), 24 Shtator 2022

<sup>78</sup> Reporter.al, [Origjina e dyshimtë e kompanisë që fitoi koncesionin 86 milionë USD të hemodializës](#), 22 Tetor 2015

<sup>79</sup> Reporter.al, [Zanafilla e inceneratorëve: Emergjencia mjedisore u shpall pa bazë ligjore](#), 2 Mars 2022

<sup>80</sup> Reporter.al, [Kuvendi miraton me 117 vota ngritjen e komisionit hetimor për inceneratorët](#), 28 Tetor 2021

<sup>81</sup> Reporter.al, [Nis komisioni për inceneratorët, PD kërkon Ramën si dëshmitar](#), 2 Nëntor 2021

<sup>82</sup> Reporter.al, [Komisioni mbyll hetimin për inceneratorët, palët do të dalin me 2 raporte](#), 25 Shkurt 2022

<sup>83</sup> Monitor.al, [Koncesioni i skanimit merr 100 mln USD pagesa buxhetore, mungojnë rezultatet në vlerë](#), 4 Janar 2023

<sup>84</sup> Reporter.al, [Koncesioni Milot-Morinë, 62 milionë euro për katër vjet](#), 7 Tetor 2021

<sup>85</sup> Reporter.al, [Protesta e Rrugës së Kombit ishte kryengritje kundër oligarkisë](#), 22 Korrik 2020

<sup>86</sup> Monitor.al, [Qeveritë kanë paguar 53 mln euro për Rrugën e Arbrit, para se të jepej koncesioni](#), 10 Tetor 2022



## Prokurimet Publike

Megjithëse prokurimi publik përbën një nga fushat më të rëndësishme ndërsektoriale, ai vazhdon të mbetet një fushë mjaft e ndjeshme sa i përket korrupsionit dhe favorizimeve, pasi shumica e rasteve kanë të bëjnë me oferta të manipuluar, dhënie të ryshfetit dhe favorizime politike ose familjare.<sup>87</sup> Përveç këtyre problematikave dhe masave të propozuara për përmirësim,<sup>88</sup> evidentohet një përqendrim i tenderave me vlera të larta tek një grup individësh të pasur, zotërues të kompanive në fushat e ndërtimit, të cilët janë njëkohësisht zotërues të koncesioneve apo projekteve strategjike.<sup>89</sup>

Situatat e emergjencës siç ishin pandemia e Covid-19 dhe ai i fatkeqsisë natyrore të tërmetit, theksuan edhe më shumë abuzimet në sektorin e prokurimeve. Duke filluar nga marsi i vitit 2020 dhe deri në janar të vitit 2023 janë shpenzuar 4,566,604,039 lekë pa TVSH për tendera për përballimin e pandemisë Covid-19.<sup>90</sup>

Institucionet publike prokuruan në mungesë transparence<sup>91</sup> miliona euro mallra dhe shërbime me procedura të cilat kufizuan konkurrencën mes operatorëve ekonomikë,<sup>92</sup> si pasojë e mosnjohimeve paraprake publike nëpërmjet të cilave ishte e pamundur të merrej një informacion mbi numrin e kompanive pjesëmarrëse si dhe kushteve apo kritereve të aplikuara për dhënien e këtyre tenderave. Ndër arsyet kryesore të mungesës së transparencës gjatë zhvillimit të këtyre tenderave konsiderohen fshehja e shkeljeve si dhe mbulimi i akteve korruptive.<sup>93</sup>

Ndërkohë mjaft i debatuar dhe kritikuar ka qenë edhe zbatimi i Programit të Rindërtimit, i cili u inicua pas tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, me qëllim kryerjen e ndërtimeve të reja dhe rikonstruksioneve të objekteve dhe infrastrukturës urbane pas vlerësimit të dëmeve të tërmetit.<sup>94</sup> Procedurat e kontraktimit për Programin e Rindërtimit kanë qenë pjesa më problematike gjatë zbatimit të tij, duke qenë se pas shpalljes së gjendjes së fatkeqsisë natyrore në vitin 2019, këto procedura u zhvilluan bazuar në një ligj të ndryshëm nga legjislacioni ekzistues për Prokurimet Publike,<sup>95</sup> si pasojë e një situatë në kushtet e emergjencës ekstreme, duke aplikuar prokurime të kufizuara (jo të hapura/pa garë) përmes Marrëveshjeve Kuadër me një afat jo më shumë se 10 ditë, me paraqitje të drejtpërdrejta pranë institucionit dhe jo përmes sistemit elektronik.<sup>96</sup>

Bazuar në monitorimin e kontraktimeve përmes dy databazave,<sup>97</sup> Open Data Albania renditi bizneset e njoftuara si Ofertues të Suksesshëm në Procedura Kontraktimi për Programin e Renditje të Operatorëve Ekonomik në Procesin e Rindërtimit sipas vlerave, dhe ajo çfarë u evidentua ishte renditja e një grupi të ngushtë biznesesh të njohura për fitimin e koncesioneve apo licensave,<sup>98</sup> por edhe kompani me pronarë në hetim.<sup>99</sup>

<sup>87</sup> Instituti Shqiptar i Shkencës, [Harta e Oligarkëve të Shqipërisë | EMRAT që kanë marrë MILIONA EURO nga Taksat e Shqiptarëve \(Sipas Qyteteve\)](#)

Top Channel Albania, [“GLLABËRIMI I PARAVE TË BUJQËSISË” - Si favorizohen njerëzit me pushtet - Inside Story](#), 1 Nëntor 2022  
Panorama.com.al, [“10 oligarkë morën 2100 tendera vitin e shkuar” - Tabaku: Rama ka falimentuar biznesin e ndershëm dhe ka varfëruar shqiptarët](#), 1 Tetor 2020

<sup>88</sup> Top Channel, [Dhoma Amerikane e Tregtisë jep 8 rekomandime për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri](#), Qershor 2022

<sup>89</sup> Open Data Albania, [100 tenderat BIG me vlerë më të lartë mbajtur në vitin 2021](#), 24 Dhjetor 2021

<sup>90</sup> Openprocurement.al, [PROKURIME NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË PËR PËRBALLIMIN E PANDEMISË COVID-19](#)

<sup>91</sup> BIRN, [“Shqetësim në Shqipëri mbi me tenderët sekret për COVID-19”](#), 7 Tetor 2020

<sup>92</sup> Reporter.al, [Tenderë pa shpallje, institucionet prokuruan 8.9 milion euro gjatë epidemisë](#), 3 Qershor 2020

<sup>93</sup> Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore, [Tendera sekretë për të fshehur shkeljet?! Ekspertët: Përdoren për të mbuluar aktet korruptive](#), 26 Shkurt 2022

<sup>94</sup> [Albania Post-Disaster Needs Assessment, Volume A Report](#), Shkurt 2020

<sup>95</sup> Ligj Nr. 97/2019 Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e Ligjit, Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqsisë natyrore”

<sup>96</sup> Po aty, Kreu VI

<sup>97</sup> OpenProcurement.al, [Prokurime në Njësi të Qeverisjes Vendore për përballimin e pasojave të tërmetit \(Nëntor 2019\)](#)

OpenProcurement.al, [Prokurime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për përballimin e pasojave të tërmetit \(Nëntor 2019\)-Programi Shtetëror i Rindërtimit](#)

